

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE  
PRISHTINË



**PUNIM DIPLOME**  
**(Master)**

*Titulli i temës:*

**PROGRAMIMI I BLOQEVE FUNKSIONALE PËRMES SIMATIC S7-300 TE SISTEMI I SHIRITIT TRANSPORTUES DHE ROBOTIT SKARA**

*Titulli i temës në anglisht:*

**PROGRAMMING FUNCTIONAL BLOCKS THROUGH SIMATIC S7-300 ON CONVEYER BELT AND ROBOT SKARA SYSTEMS**

**Mentori:**  
**Prof. Dr. Agron Pajaziti**

**Kandidati:**  
**Bach. i mak. Muhamet Berisha**

**Prishtinë**

**2019**

**PËRMBAJTJA**

1.Hyrje .....	9
1.1. Përdorimi .....	9
1.2. Përdorimi special .....	10
1.3. Kostoja e ulët inxhinierike .....	10
1.4. Kostoja e ulët e operimit .....	10
3. SIMBOLET DHE VARIABLAT PËR PROGRAMIMIN E PLC-së .....	14
3.1. Urdhërat e përdorur për programimin .....	14
3.2. SIMBOLET .....	15
3.2.1. Simboli “&” (dhe, AND) .....	15
3.2.2. Simboli barazim ( Assing ) .....	15
3.2.3. Operacioni logjik OSE ( $\geq 1$ ) .....	16
3.2.4. Vija e mesme dalëse “ # ” ( Midline Output ) .....	16
3.2.5. Detektimi i RLO-së pozitive ( P ) .....	16
3.2.6. Starto prodhimin (vendos dalje) S Set Output .....	17
3.2.7. Ristarto prodhimin (rivendos dalje) R Reset Output .....	17
3.2.8. Starto_Ristarto Flip Flop (vendos_rivendos) SR Set_reset Flip Flop .....	17
3.2.9. Ristarto_Starto Flip Flop (rivendos_vendos) RS Reset_set Flip Flop .....	18
3.2.10. Krahasimi i dy vlerave .....	18
3.2.11. Lëvizja (Move): Transferimi i vlerave .....	18
3.2.12. Kalimi i pa kushtëzuar dhe kalimi i kushtëzuar në bllok .....	19
4.1. DIZAJNI DHE QARKU .....	20
4.2. Shembulli 1: Numërimi dhe Krahasimi i Urdhërave .....	25
4.2.1. Zona e Ruajtjes me numërues dhe krahasues .....	25
4.2.2. Programimi logjik që i aktivizon llambat e indikatorit në panelin tregues .....	26
4.3 Shembulli 2: Udhëzimet matematikore .....	28
4.3.1. Zgjedhja e problemeve matematikore .....	28
4.3.2. Programi logjik ”Ladder” .....	28
4.4. Shembulli 3: Udhëzimi i fjalës logjike .....	29
4.4.1. Sistemi i ngrohjes së furrës .....	29
4.4.2. Program logjik shkallë “Ladder Logic” .....	30

5. Zgjidhja e elementeve përbërëse të robotit .....	31
5.1 Elementet përbërëse të shiritit transportues dhe robotit skara.....	31
5.1.1 Aplikime praktike .....	31
5.1.2 Udhëzimet e përdorura .....	31
5.2. Elementet përbërëse të shiritit transportues dhe robotit skara.....	32
5.2.1 Shiritit transportues me elementet përbërëse.....	32
5.2.2 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit të tretë .....	33
5.2.3 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit dytë .....	34
5.2.4 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit të parë dhe me komandat e lëvizjes.....	35
6. Programimi i blloqeve funksionale, me përshkrimin e sistemit dhe programimin e shiritit transportues përmes Simatic S7-300.....	38
6.1. Programimi i shiritit transportues .....	38
6.2. SHPJEGIMI I BLOQEVE FUNKSIONALE TË PROGRAMIMIT TË SHIRITIT TRANSPORTUES .....	39
6.2.1. OBI – Cikli i programimit dhe Organizimi i Blloqeve .....	39
6.2.2. Kuptimi i funksionimit të bllokut OBI.....	40
6.2.3. Të dhënat lokale për OBI .....	40
6.2.4. Programi kryesor me lëvizje të pandërprerë .....	42
6.3. PROGAMIMI I BLOQEVE FUNKSIONALE (FB).....	42
6.3.1. Bllok Funkcioni dhe Blloku i të Dhënave (FB dhe DB) .....	43
6.3.2. Variablat e të dhënave të tipit FB .....	43
6.3.3. Caktimi i parametrave aktual për parametra formal.....	43
6.3.4. Caktimi i vlerave fillestare te parametrat formal. ....	44
6.4. SHPJEGIMI I BLOKUT FUNKSIONAL FB1 .....	45
6.4.1. Simboli SR (Set Reset Flip Flop).....	45
6.4.2. Thirr FB nga kutia (CALL_FB) .....	46
6.4.3. Përshkrimi për thirrjen e bllokut FB.....	46
6.4.4. Thirr bllok/sistemin FB nga kutia (CALL_SFB).....	47
6.4.5. Përshkrimi për thirrjen SFB .....	47
6.4.6. Kohuesi (Timer) T1 .....	50
6.4.7. Udhëzimi i MOVE (lëviz) i integruar në Bllokun FB1, na lejon që të prodhojmë hapësirë kohore me frekuenca të ndryshme në daljen Q12.0 përmes Q13.7.....	52

6.4.8. Sensorët detektues të programuar në bllokun FB2 .....	53
6.4.9. Blloku funksional FB2 i integruar në bllokun e të dhënave DB2 në kuadër të bllokut kryesorë OB1 .....	54
6.4.10. Gjendja e sinjalit në motor.....	55
6.4.11. Numruesi (S_CU) i cili shërben për integrimin e sensorit numërues, si dhe qëndrimi në lëvizje të pandërprerë i shiritit transportues.....	56
6.5. PROGRAMIMI I SENSORIT INDUKTIV I INTEGRUAR NË BLOKUN FUNKSIONAL FB2. ..	57
6.5.1. Shembulli DB (bllok i të dhënave) .....	58
6.5.2. Krijimi themelorë i një blloku DB.....	58
6.6. BLOKU FUNKSIONAL FCs .....	59
6.6.1. Aplikimi.....	59
6.6.2. Dallime të rëndësishme në mes të parametrave të jashtëm FCs dhe FBs.....	59
6.6.3. Thirrja bllokut FC nga kutia, (CALL_FC).....	60
6.6.4. Thirr sistemin FC nga kutia (CALL_SFC).....	61
6.6.5. Blloku Funksional FC1 .....	62
6.7 Procesi i programimit të robotit Skara .....	63
6.8 OB1 Programi organizativ kryesor i funksionit të robotit Skara.....	64
6.8.1 Përshkrimi i ciklit të programit të bllokut organizativ OB1.....	64
6.9. OB100 Nënprogrami kryesor organizativ i robotit SKARA.....	64
6.9.1 Startimi i bllokut organizativ OB100.....	64
6.10. FB51 Blloku Funksional .....	65
6.10.1 Objektet dhe hierarkia e objekteve .....	65
6.10.2 DB Bllok i të dhënave.....	66
6.10.3 Krijimi themelor i një blloku DB .....	66
6.10.4 FC Blloku Funksional .....	66
6.11 SFB47 Sistemi i blloqeve funksionale .....	67
6.11.1 Kontrollimi i numëruesve me SFB47 “COUNT” .....	67
7. Programimi i lëvizjes të robotit skara përmes PLC Simatic S7-300 .....	68
7.1 OB1 Programi organizativ kryesor i funksionit të robotit Skara.....	69
7.1.1 OB1 “Qarku i programit kryesor (cikli)” .....	69
7.2 OB100 Nënprogrami kryesor organizativ i ROBOTIT SKARA .....	74
7.2.1 OB100 “Ristartimi i plotë i OB1” .....	74

<i>7.3 FB51 Blloku Funkcional</i> .....	75
<i>7.4 FC5: FUNKSIONI</i> .....	83
<i>7.5 FC10 Nën funksioni i programimit të lëvizjeve të robotit SKARA</i> .....	86
KONKLUSIONE DHE PËRFUNDIMI .....	93
LITERATURA E SHQYRTUAR.....	94

## Lista e figurave

<b>Figura 1.1</b> Linja e prodhimit në industrin automobilistike – automatizuar me S7-300.....	9
<b>Figura 1.2</b> Procesi fizik dhe sistemi i kontrollit.....	12
<b>Figura 4.1</b> Konfigurimi i S7-300:hapsirë-ruajtëse,modular dhe jashtëzakonisht i thjeshtë.....	20
<b>Figura 4.2</b> Ndërfaqja e integruar e S7-300 CPU për lidhje direkte në MPI dhe PROFIBUS DP .....	21
<b>Figura 4.3</b> CPU 314C-2 DP dhe CPU 315-2 DP (djathtas).....	22
<b>Figura 4.4</b> CPU 317-2 DP_ CPU standarde me dy DP Interfaces (ndërfaqje .....	24
<b>Figura 4.5</b> CPU 317T-2 DP_teknologjia CPU për funksionin e kontrollit të lëvizjeve.....	24
<b>Figura 4.6</b> Paneli tregues në shiritin transportues .....	26
<b>Figura 4.7</b> Tregon metoden manuale për startim, duke shtypur butonin me dorë.....	29
<b>Figura 5.1</b> Shiriti transportues) .....	32
<b>Figura 5.2</b> Roboti Skara aksi i tretë .....	33
<b>Figura 5.3</b> Roboti Skara aksi i dytë .....	34
<b>Figura 5.4</b> Roboti Skara aksi i parë.....	35
<b>Figura 5.5</b> Shiriti transportues .....	36
<b>Figura 5.6</b> Cilindri pneumatik.....	37
<b>Figura 6.1</b> Realizimi i punës së shiritit transportues .....	38
<b>Figura 6.2</b> Hiearkia e objekteve .....	66
<b>Figura 7.1</b> Roboti Skara.....	68
<b>Figura 7.2</b> Pamja e PLC68.....	69


## Lista e tabelave

<b>Tabela 4.1</b> Të dhëna të përgjithshme të CPU-ve.....	23
<b>Tabela 4.2</b> Treguesi i komponenteve të sistemit dhe adresat absolute.....	29
<b>Tabela 5.1</b> Udhëzimet e përdorura.....	31
<b>Tabela 6.1</b> Organizimi i blloqeve, cikli i programimit për shiritin transportues.....	39
<b>Tabela 6.2</b> Struktura e blloqeve në programin burimorë.....	39
<b>Tabela 6.3</b> Variablat, tipet dhe përshkrimi për OB1.....	41
<b>Tabela 6.4</b> Caktimi i parametrave aktual, si dhe variablat hyrëse dhe dalëse në bllokun FB....	44
<b>Tabela 6.5</b> Caktimi i vlerës fillestare përmes variablave.....	44
<b>Tabela 6.6</b> Eelementet përbërëse në hyrje dhe dalje, parametrat, lloji i të dhënave dhe përshkrimi.....	45
<b>Tabela 6.7</b> Parametrat, lloji i të dhënave, zona e memories dhe përshkrimi për bllokun FB.....	46
<b>Tabela 6.8</b> Parametrat, lloji i të dhënave, zona e memories dhe përshkrimi për bllokun FB ...	47
<b>Tabela 6.9</b> Të dhënat programuese në hyrje të bllokut FB1.....	48
<b>Tabela 6.10</b> Të dhënat programuese në dalje të bllokut FB1.....	48
<b>Tabela 6.11</b> Tregon gjendjen e programuar të pandryshuar në numrim.....	48
<b>Tabela 6.12</b> Tregon gjendjen e pandryshuar të thirrjes së shiritit.....	48
<b>Tabela 6.13</b> Parametrat, lloji i të dhënave, zona e memories si dhe përshkrimi.....	50
<b>Tabela 6.14</b> Tregon gjendjen e dhënë në simbloin MOVE me të gjithë parametrat e dhënë.....	52
<b>Tabela 6.15</b> Paraqitja e të dhënave hyrëse për programimin e sensorit induktiv II.....	53
<b>Tabela 6.16</b> Paraqitja e të dhënave dalëse për programimin e sensorit induktiv II.....	53
<b>Tabela 6.17</b> Deklarimi, emri, adresa, tipi, vlera fillestare, komentimi.....	58
<b>Tabela 6.18</b> Deklarimi, emri, adresa, tipi, vlera fillestare, komentimi.....	58
<b>Tabela 6.19</b> Parametrat, lloji i të dhënave, zona e memories, si dhe përshkrimi për bllokun FC.....	60
<b>Tabela 6.20</b> Parametrat, lloji i të dhënave, zona e memories, si dhe përshkrimi për bllokun FC i.....	61
<b>Tabela 6.21</b> Thirrjet e OB-ve.....	65

# KAPITULLI I

## 1.Hyrje

S7-300 është programi më i kërkuar i kontrollit SIMATIC i cili mundëson zgjidhjen e problemeve automatike me sukses të lartë. S7-300 për sistemin e zgjidhjeve me theks të veçantë në inxhinierinë e prodhimit ka dëshmuar një platformë universale automatike që do të thotë një zgjidhje optimale për problemin tuaj. Parametrat e integruar në të e bëjnë këtë platformë vazhdimisht më të kërkuar [5], [6].



*Fig. 1.1. Linja e prodhimit në industrinë automobilistike – automatizuar me S7-300*

### 1.1. Përdorimi

SIMATIC S7-300 ofron zgjidhje për problemet e ndryshme automatike në fushat si në vijim:

- Inxhinierinë e prodhimit
- Industrinë automobilistike
- Konstruksionet e përgjithshme makinerike
- Konstruksionin e makinave speciale
- Konstruktimin e makinave serike (të gjitha llojet e makinave prodhuese)
- Përpunimin e plastikës
- Industrinë e paketimit (Ambalazhimit)
- Industrinë e ushqimit dhe duhanit
- Procesin inxhinierik (p.sh furnizimi me ujë, inxhinierinë e ndërtimit).



### ***1.2. Përdorimi special***

Për përdorime special kemi produkte të veçanta të dizajnuara me ndihmën e S7-300 si në vijim:

- Aplikimi i ruajtjes nga dështimi me aplikacionin e ri S7-300F sikurse I/O ku këto aplikime tani janë të mundshme,
- Për aplikacionet e kërkuara teknologjike dhe funksionin e kontrollit të lëvizjeve, mund të përdoret teknologjia speciale CPU,
- Në të jejtën kohë njësitë e kompletuara SIMATIC C7 janë të lejuara në S7-300 CPU, me integrimin e HMI-së për konfigurimin dhe kontrollin makinerik ku hapsira është e kufizuar,
- Ky spektër është një çark i ndalur nga CPU në formën e konfigurimit ET 200S, e cila bënë shpërndarjen ku procesi intelgjent është i mundur.

### ***1.3. Kostoja e ulët inxhinierike***

S7-300 karakterizohet nga efiqienca e konfigurimit dhe programimit, e cila rezulton me kosto të ulët inxhinierike. Kualiteti i tërësishëm i strukturave të CPU-së e bënë S7-300 një platformë ideale për problemet e caktuara në STEP 7, që është një mjet inxhinierik në përputhshmëri me standardin IEC 61131-3, për shembull në nivele të larta të gjuhës.

Përveç kësaj, teknologjia orientohet nga kohëzgjatja e softverit, p.sh. kontrolli i lëvizjeve të lehta mundë të përdoret për detyrën e kontrollit të lëvizjes. Mjetet inxhinierike gjithashtu janë lehtësuar me programimin modular dhe riparimin e softverit ekzistues. Veglat inxhinierike nuk mbështesin vetëm zhvillimin por gjithashtu edhe riparimin, lehtësimin e mirëmbajtjes dhe dokumentimin e programit. Konfigurimi i procesit të diagnostifikimit për analizimin e dështimeve të mundshme, reduktimin e humbjeve kohore dhe rritjen e produktivitetit janë implementuar në koston inxhinierike.

### ***1.4. Kostoja e ulët e operimit***

Mikro karda e memorjes The Micro Card (MMC) mund të kryejë funksionin si vend ruajtje e të dhënave të programit, prandaj nuk është e nevojshme të ketë bateri rezervë dhe kostoja e mirëmbajtjes mund të ruhet pjesërisht. MMC gjithashtu mund të ruaj një projekt, duke përfshirë këtu simbolet dhe komentet të cilat e bëjnë më të lehtë përdorimin pasi që nuk ka të dhëna të nevojshme në mjetet përkatëse.

MMC lehtësisht freskon të dhënat. Kjo lejon leximin dhe shkrimin e hyrjes edhe përgjatë ekzekutimit, sikurse në shembujt e arkivimit të vlerave për matje ose përpunimi i mjeteve, në mënyrë që leximi dhe shkrimi të bëhet më i lehtë.

## KAPITULLI II

Automatizimi i proceseve industriale mund të përcaktohet si disciplina që studion metodologjitë dhe teknologjitë që lejojnë kontrollin e fluksit të energjisë, të materialeve dhe të informacioneve të nevojshme për realizimin e proceseve prodhuese, pa ndërhyrjen e njeriut. Termi “automatizim” u përdor për herë të parë në vitin 1946 nga shoqëria ”Ford Motor” në SHBA (USA) për të kualifikur ciklin e vet të prodhimit të motorëve.

Për kushtet e sotme modern të prodhimit, është i nevojshëm një automatizim shumë fleksibil që mundë të përcaktohet si “personalizmi i masës”. Përpara erës industriale, prodhimi ishte artizanal dhe, si rrjedhojë, rezultonte në personalizim të lartë të prodhimeve. Industrializimi dhe prodhimi në masë solli edhe njëtrajtësimin e prodhimit. Më pas u kalua në një fazë ku prodhimit në masë iu bashkangjiti një varietet më i madh karakteristikash të prodhimeve, për tu arritur në fazën e sotme në të cilën është rritur shumë ky varietet, duke realizuar pikërisht atë që përcaktohet si “personalizim i masës” [1], [2].

Rëndësia e automatizimit të proceseve prodhuese moderne rrjedh nga një tërsi faktorësh, jo vetëm ekonomike, ku do të përmendim:

- Përmirësimin e cilësive të prodhimit;
- Mundësia e përdorimit të një impianti të vetëm për shumë lloje prodhimesh;
- Shkurtimin e kohëve të prodhimit;
- Mundësinë e reduktimit të magazinave për hyrje dhe dalje;
- Zvoglimin e jashtëzakonshëm të skarciteteve të prodhimeve;
- Koston më të vogël të prodhimit;
- Nevojen për t’u përshtatur me rregullat dhe ligjet që pengojnë punën me dorë në disa drejtime të industrisë (p.sh., industria farmaceutike dhe ushqimore);
- Mundësinë e reduktimit të impaktit ambiental dhe kursimin e energjisë.
- Në një sistem industrial dallojmë procesin fizik dhe sistemin e kontrollit (Fig.2.1.).

Procesi fizik mund të përcaktohet si kombinim i veprimeve që veprojnë mbi entitete të botës fizike, duke i ndryshuar disa karakteristika. Veprimet e lëvizjes, përpunimet mekanike, reaksionet kimike dhe rrjedhja e flukseve energjetike janë disa nga veprimet që e kënaqin këtë përcaktim dhe si rrjedhojë, mundë të konsiderohen procese fizike; si të tilla janë edhe objekt i automatizimit. Nga ana tjetër, trajtimi i pastër i informacioneve nuk sjell ndryshime në botën reale dhe nuk mund të konsiderohet proces fizik.




Fig. 1.2. Procesi fizik dhe sistemi i kontrollit

Një procesi fizik merr në hyrje materiale në formën e prodhimeve të përpunuara dhe energji. Ai gjithashtu merr edhe nga sistemi i kontrollit informacione në forma të ndryshme, si vlera tensionesh ose rrymash elektrike, presion të një lëngu apo skena vlerash binare të koduara.

Procesi prodhon në dalje material në formën e prodhimeve të varura edhe nga energjia. Ai, gjithashtu, dërgon informacione drejt sistemit të kontrollit. Edhe zhurmat që vijnë nga mjedisi dhe që veprojnë mbi proces mund të konsiderohen si hyrje të tij, por si të pamodifikueshme sipas dëshirës [2], [3].

Informacionet në dalje sigurohen nga pajisje të caktuara që përbëhen nga sensorë, të cilët transformojnë variablin që duhet marrë në tipin e madhësisë që përshtatet për matjen, dhe nga një përbërës të quajtur transduktor, i cili pranon informacione në formë të variablave fizike apo kimike dhe e konverton në madhësi të një natyre tjetër, kryesisht elektrike, e përshtatshme për t'u transmetuar. Shumë shpesh, sensorët dhe transduktorët ndodhen në të njëjtin element, dhe kjo është arsyeja se pse përgjithësisht me sensor (ose transduktor) i referohemi një pajisje që është në gjendje të masë një madhësi duke dhënë në dalje një sinjal kryesisht të tipit elektrik, që lidhet me të.

Informacionet në hyrje përdoren nga aktuatorët për të alternuar vlerën e variablave të kontrollit të procesit. Zakonisht, aktuatorët, që siç quhen ndryshe *elementët e fundëm të kontrollit*, paraprihen nga pre-aktuatorët, të cilët realizojnë kthimin e informacionit dhe amplifikimin e fuqisë.

Për shembull, një valvol është pajisja e fundme e kontrollit për rrjedhjen e një lëngu në një tub, ndërsa motori elektrik që e vë në lëvizje bashkë me funksionimin e tij është pre-aktuatori.

Sensorët, aktuatorët dhe pre-aktuatorët mund të konsiderohen si pjesët realizuese të një procesi fizik dhe përbëjnë ndërfaqen kundrejt sistemit të kontrollit.

Sistemi i kontrollit, si rrjedhojë, merr informacion mbi gjendjen e procesit nëpërmjet sensorëve, i përpunon nëpërmjet algoritmeve të specifikuar dhe u dërgon aktuatorëve informacionet në lidhje me veprimet që duhet të kryhen për të realizuar kontrollin e procesit fizik.

Për këtë qëllim, ai merr formën edhe nga një ose më shumë entitete të jashtme, të cilat mund të jenë operatorë njerëzorë ose sisteme të tjera kontrolli hierarkisht më të lartë.

Ky sistem gjithashtu, është në gjendje t'u dërgojë këtyre entiteteve të jashtme informacione mbi gjendjen dhe mbi procesin e kontrolluar. Nga paraqitja e mësipërme e sistemit të kontrollit rezulton se ai merr, përpunon dhe dërgon informacione, ndaj dhe duhet trajtuar si një sistem që trajton informacionet, pra, një sistem informatik.

Një sistem kontrolli është një aplikim i asaj që sot përcaktohet si teknologjia e informacionit dhe komunikimit (ICT, Information and Communication Technology).

## KAPITULLI III

### 3. SIMBOLET DHE VARIABLAT PËR PROGRAMIMIN E PLC-së

#### 3.1. Urdhërat e përdorur për programimin

Urdhërat e “Bit Logic” punojnë me dy shifra, 1 dhe 0. Këto dy shifra e formojnë bazën e një sistemi numrerik të quajtur sistem binar. Të dy shifrat 1 dhe 0 quhen shifra binarë apo bita. Në botën e kontakteve dhe mbështjelljeve, një “1” tregon që një gjendje është aktivizuar apo ka energji, dhe një “0” tregon se nuk shprehet aktivizim ose mund të themi se nuk ka energji. Udhëzimet “Bit Logic” tregojnë gjendjet e sinjalit “1” dhe “0”, të kombinuara sipas logjikës së Boolean. Këto kombinime që prodhojnë rezultat prej gjendjes “1” ose “0” quhen rezultat i operacionit të logjikës (RLO).

Operacionet logjike që janë shkaktuar nga udhëzimet Bit Logic kryejnë një sërë funksionesh. [6], [7].

Ekzistojnë shumë udhëzime Bit Logic për të kryer operacionet e mëposhtme:

- ---|---            Kontakti normalisht i hapur (Address)
- ---| / |---        Kontakti normalisht i mbyllur
- ---(SAVE)        Ruajtja e RLO në kujtesën BR
- XOR            Bit ekzkluziv OR
- ---( )            Spirale dalëse ose (prodhuese)
- ---( # )---        Mesvijë prodhuese
- ---|NOT|---       Energji rrjedhëse anasjelltas.

Udhëzimet e mëposhtme reagojnë ndaj një RLO nga gjendja “1”

- ---( S )           Spirale e vendosur (Set Coil)
- ---( R )           Spirale e rivendosur (Reset Coil)
- SR            Vendos Rivendos “Flip Flop” (Set Reset)
- RS            Rivendos Vendos “Flip Flop” (Reset Set).

Udhëzimet tjera reagojnë në tranzicionin pozitiv ose negative, për të kryer funksionet e mëposhtme:

- ---(N)--- Zbulimi negativ RLO
- ---(P)--- Zbulimi pozitiv RLO
- NEG Buzë-zbulimi apo Adresimi ngative
- POS Buzë-zbulimi apo Adresimi pozitiv
- Immediate Read (Lexim i menjëhershëm)
- Immediate Write (Shkrim i menjëhershëm).

### 3.2. SIMBOLET


#### 3.2.1. Simboli “&” (dhe, AND)



Me “&” (AND) mund të kontrollojmë sinjalin e “2” ose më shumë hyrjeve specifike. Nëse gjendja e sinjalit është “1” kushti është i mjaftueshëm dhe rezultati i daljes është i barabartë me “1” (në këtë rast njësia hyrëse është e barabartë me njësinë dalëse).

Nëse sinjali i hyrjes është “0” (Zero) kushti është i pa mjaftueshëm, dalja është “0”. Nëse blloku “&” është blloku i parë në operacionin logjik, ai ruan rezultatin nga R20 bit. Çdo bllok “&” i cili nuk është bllok i parë, kombinon rezultatin e sinjaleve hyrëse me vlerën e ruajtur nga biti RLO. Këto vlera kombinohen në bazë të tabelës së bllokut “&” (AND).

#### 3.2.2. Simboli barazim ( Assing )




Ky simbol prodhon rezultatin e operacioneve logjike. Simboli në fund të operacionit logjik ka sinjalin “1” ose “0” bazuar në këto kritere:

Sinjali në dalje është “1” kur kushti i operacionit logjik para daljes në kuti është i plotësuar.

Sinjali është “0”, kur kushti nuk është plotësuar.


### 3.2.3. Operacioni logjik OSE ( $\geq 1$ )



Me operacionin logjik OSE ( $\geq 1$ ) mund të kontrollojmë sinjalin hyrës të dy ose më shumë adresave hyrëse. Nëse gjendja e njërit nga sinjalet hyrëse është “1” kushti plotësohet, operacioni logjik OSE prodhon rezultatin në dalje 1. Nëse gjendja e sinjalit nga të gjitha adresat është “0” kushti nuk plotësohet, rezultati në dalje është “0”. Nëse operacioni logjik OSE është operacioni i parë në varg ai i ruan rezultatet e gjendjes së sinjalit në RLO bit.


Secili operacion logjik OSE që nuk është operacioni i parë në varg kombinon rezultatin e sinjalit të kontrolluar të tij me vlerën e ruajtur nga biti RLO.

### 3.2.4. Vija e mesme dalëse “#” (Midline Output)




Vija e mesme dalëse është një element ndërmjetësues i cili e amortizon RLO-në. Më saktësisht ky element amortizon operimin e bitit logjik të fushës së fundit në mënyrë që të hapet para daljes së vijës së mesme. Ky operacion dirigjohet nga Master Contro Rele (MCR) Releja master kontrolluese.

### 3.2.5. Detektimi i RLO-së pozitive (P)




Operacioni i Detektimit të RLO-së Pozitive është operacioni i cili detekton ndryshimin nga “0” në “1” të adresës specifike dhe në të ndikon një RLO me vlerë “1” pas udhëzimit. Gjendja e sinjalit aktual të RLO-së është e kombinuar me gjendjen e sinjalit të adresës. Nëse gjendja e sinjalit të adresës është 0 dhe RLO ka vlerë “1” para udhëzimit të këtij operacioni, RLO do të jetë “1” (pulës) pas udhëzimit. Në të gjitha rastet e tjera RLO është “0”.

### 3.2.6. Starto prodhimin (vendos dalje) S Set Output




Udhëzuesi “Starto prodhimin” ekzekutohet vetëm atëherë kur RLO është “1”. Ky udhëzues vendos adresat specifike në “1”. Nëse RLO është “0” ky udhëzues nuk ka ndikim në adresën specifike, që do të thotë ska ndryshim. Udhëzuesi Start dirigjohet nga Master Kontroll Rele MCR.

### 3.2.7. Ristarto prodhimin (rivendos dalje) R Reset Output



Udhëzuesi Ristarto prodhimin ekzekutohet vetëm atëherë kur RLO është “1”. Nëse RLO është “1” ky udhëzues ristarton adresat specifike në “0”. Nëse RLO është “0” udhëzuesi nuk ka efekt në adresat specifike që do të thotë nuk ka ndryshim. Ky udhëzues dirigjohet nga Master Kontroll Rele MRC.


### 3.2.8. Starto\_Ristarto Flip Flop (vendos\_rivendos) SR Set\_reset Flip Flop



Udhëzuesi starto\_ristarto flip flop egzekuton startimin (S) ose ristartimin (R) vetëm kur RLO është “1”. Kur RLO është “0” ky udhëzues nuk ka efekt. Udhëzuesi SR startohet kur gjendja e sinjalit në hyrje S është “1” dhe gjendja e sinjalit në hyrje R është “0”. Kur gjendja e sinjalit në hyrjen S është “0” dhe në hyrjen R është “1”, Flip flopi ristartohet. Nëse një RLO në të dyja hyrjet S dhe R është “1” Flip Flopi Ristartohet. Ky udhëzues dirigjohet nga Master Kontroll Rele MRC.




**3.2.9. Ristarto\_Starto Flip Flop (rivendos\_vendos) RS Reset\_set Flip Flop**



Udhëzuesi Ristarto\_Starto Flip Flop ekzekuton startimin (S) ose ristartimin (R) vetëm kur RLO është “1”. Një RLO me vlerë “0” nuk ka efekt në këtë udhëzues, ky udhëzues ristartohet kur gjendja e sinjalit në hyrjen R është “1” dhe në hyrjen S është “0”.


Nëse hyrja R është “0” dhe hyrja S është “1” flip flopi startohet. Nëse të dy hyrjet e RLO-së R dhe S janë “1” flip flopi startohet. Ky udhëzues dirigjohet nga Master Kontroll Rele MRC.

**3.2.10. Krahasimi i dy vlerave**



Udhëzuesi i krahasimit të dy vlerave krahason dy vlera nga baza 32 bit me pikën qarkulluese të numrave. Ky udhëzues krahason hyrjet IN1 dhe IN2 bazuar në llojin e krahasusit, për secilin rast konkret CMP == D, CMP > D, CMP >= D, CMP <> D, CMP < D, dhe CMP <= D.

**3.2.11. Lëvizja (Move): Transferimi i vlerave**



Me udhëzuesin për transferimin e vlerave mund të transferojm vlerat specifike në variabla. Vlera specifike e hyrjes IN kopjohet në adresën specifike në daljen OUT. ENO ka gjendjen e sinjalit të njëjtë sikurse EN. Me kutinë zhvendosëse udhëzuesi i transferimit të vlerave mund të kopjon të gjitha të dhënat elementare me 8, 16 ose 32 bit.

Mund të caktojm llojin e të dhënave sikurse në grupe ose struktura të cilat duhet të kopjohen në sistemin e funksionit SFC 20 “BLKMOV”. Ky udhëzues dirigjohet nga Master Kontroll Rele MCR.

### 3.2.12. Kalimi i pa kushtëzuar dhe kalimi i kushtëzuar në bllok



Urdhëri i kalimit të pa kushtëzuar në bllok korrespondon në urdhërin “shko tek emertimi”, asnjëri nga urdhërat në mes të kalimit dhe emertimit nuk ekzekutohet. Ky urdhër mund të përdoret nga të gjitha blloqet logjike p.sh blloqet organizative (OB-të), blloqet funksionale (FB-të), dhe funksionet (FC-të). Nuk duhet të ketë asnjë operacion logjik para kutisë së kalimit të pa kushtëzuar.



Për dallim nga kalimi i pa kushtëzuar në bllok, te kalimi i kushtëzuar urdhëri ekzekutohet vetëm në rastin kur RLO është “1”. Parkim, ku kamionët marrin pakot aty për aty, për dërgim tek konsumatorët. Një pengesë fotoelektrike (SENSOR) i vendosur në fund të shiritit transportues 2 afër zonës së magazinimit, përcakton se sa paketa do të largohen nga zona e magazinimit, për të shkuar në vend-ngarkim.

# KAPITULLI IV

## 4.1. DIZAJNI DHE QARKU

### 4.1.1. Dizajnimi

S7-300 mundëson një hapësirë për ruajtjen e konfigurimit modular të makinave kontrolluese, për adaptimin e mundësisë së zgjidhjeve të problemeve me dorë, pa marrë para sysh rezultatet e caktuara.

Një freskues nuk është i nevojshëm gjatë operimit. Kur është dizajnuar modelimi është bazuar në standardin gjerman DIN. Konfigurimi është i mundshëm dhe i fuqizuar në pajtueshmëri elektromagnetike.

Moduli i shumëllojshmërisë së spektrit S7-300 mund të përdoret për zgjerimet e centralizuara sikurse për konfigurimin e thjeshtë në strukturën e ET 200M; kjo rezulton në kosto, efikasitet, kursim dhe mirëmbajtje [4], [5].




Fig. 4.1. Konfigurimi i S7-300: hapësirë-ruajtëse, modular dhe jashtëzakonisht i thjeshtë

#### 4.1.2. Fuqia, rrjeti fleksibil

Ndërfaqja e integruar direkt në CPUs lejon konfigurimin e pamjeve që mundëson instalimin e standardeve të teknologjisë, dhe pajisjet e programimit p.sh., për HMI. Ka lidhje të mjaftueshme të një numri të paisjeve HMI. Kursi i këti funksioni të pajisjeve programuese mundëson lidhjet në cilëndo pikë të qarkut, dhe mundëson adresimin e të gjitha nyjeve në qark.




Fig. 4.2. Ndërfaqja e integruar e S7-300 CPU për lidhje direkte në MPI dhe PROFIBUS DP.

#### 4.1.3. Pika e shumfishtë e ndërfaqies – MPI

MPI është zgjidhje me kosto të ulët për komunikim me veglat programuese dhe PC-së (kompjuterit), sistemit HMI (R), dhe kontrolluesit tjetër SIMATIC S7/C7/W në AC. Ndalesat totale 125 MPI mund të lidhen në transmisionin e shkallës 187.5 kbit/s, p.sh., për shkëmbimin e të dhënave në mes të kontrollerëve të ndryshëm ose funksioneve HMI pa pasur nevojë për ndonjë programim të lartë. Me CPU 317 dhe 318-2 DP, MPI gjithashtu mund të përdoret si PROFIBUS DP dhe lejon konfigurimin e dy linjave DP.

#### 4.1.4. Profibus DP

Për konfigurimin ekonomik të rrjeteve të madha shpërndarëse, SIMATIC S7-300 mund të lidhet me PROFIBUS DP (bazuar në EN 50170). PROFIBUS DP mundëson komunikim të shpejtë me partner të shumëllojshëm, pra komunikimin nga kontrolleri SIMATIC në ekipin e veglave të fushës së tretë.

Gjithashtu komunikimi me SIMATIC S5 ose SIMATIC 505 ku sistemet ekzistuese mund të konfigurohen.

Shperndarja I/Os mund të konfigurohet me STEP 7 si I/O të përqëndruara e cila ruan shumë fletëngarkesa inxhinierike. S7-300 përdoret si kontrollor dhe mbikqyrës.

Sistemi është i hapur që nga mbështetja e funksionalizimit të DP V1. Bën caktimin dhe diagnostifikimin e parametrave për sistemet e rrjetit të lidhur me PROFIBUS në fushën e tretë.

Për përdorim në të ardhmen CPU-ja e re që ka të integruar Ethernet/PROFINet, ndërfaqje për komponentet e bazave automatike, kontrollin e programimit, operimit si dhe monitorimin përmes internetit do të jetë i mundshëm.

#### 4.1.5. Spektri CPU

Për ndërtimin e një sistemi të programimit kontrollues, përdoruesi duhet të zgjedhë një nga shkallët e spektrit të CPU-së, nga modeli startues e deri te performancat e larta të CPU-së. CPU-ja mundëson cikle punuese të shkurtëra të makinave duke u bazuar në shpejtsinë e performancës së saj. Moduli i ngushtë mundëson kontrollimin kompakt të konfigurimit dhe kontrollimin e dimensioneve të vogla të kabinetit kontrollues. Të ashtuquajturat standardet e CPU-së kanë një gjërësi prej vetëm 40 mm, dhe gjithashtu mundësojnë dizajnimin e dy ruajtësve nga dështimi. Komponentet e ndryshme CPU me gjërësi 80 deri 120 mm gjithashtu mund të integrojnë I/O dhe funksionet e tjera teknologjike [3], [7].



Fig.4.3. CPU 314C-2 DP dhe CPU 315-2 DP (djathtas)

Në Tabelën në vazhdim janë paraqitur të dhëna të përgjithshme, mbi CPU të llojeve të ndryshme.




Dizajni	CPU	Fillimi i dërgesës	Ndërpamja e integruar	Integrimi I/O	Integrimi i funksioneve teknologjike	Specifikimi teknologjikal: shiko faqen
Stabdardet e CPUs	CPU 312	3ti vendosur në 03	MPI			6
	CPU 314		MPI			6
	CPU 315-2 DP		DP, MPI			6
	CPU 317-2 DP 		DP, DP/MPI			6
	CPU 318-2 DP		DP, DP/MPI			7
Ruajtja e dështimit CPU	CPU 315F-2 DP	3ti vendosur në 03	DP, MPI		Fail-safety	7
	CPU 317F-2 DP 		DP, DP/MPI		Fail-safety	7
Kompakti CPU	CPU 312C	4ti vendosur në 03	MPI	Digital	Numërimi	8
	CPU 313C		MPI	Digital, analog	Numërimi	8
	CPU 313C-2 PtP		PtP, MPI	Digital	Numërimi	8
	CPU 313C-2 DP		DP, MPI	Digital	Numërimi	8
	CPU 314C-2 PtP		PtP, MPI	Digital, analog	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Numërimi</li> <li>▪ Pozicionimi</li> </ul>	9
	CPU 314C-2 DP		DP, MPI	Digital, analog	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Numërimi</li> <li>▪ Pozicionimi</li> </ul>	9
Teknologjia CPU	CPU 317T-2 DP 	4ti vendosur në 03	DP, DP/MPI	Digital	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Sinkronizim,</li> <li>▪ Rrugëtimi për gjetjenë stopit</li> <li>▪ Shtyp shenjën e kontrollit</li> <li>▪ Ndërrimi kompjuter ik</li> <li>▪ Kontrollimi i pozicionimit</li> </ul>	9

Tabela 4.1. Të dhëna të përgjithshme të CPU-ve.

#### 4.1.6. Të rejat në CPU

Të gjitha CPU-të 317 kanë 512 KB për memorien e punimit dhe mundësitë gjithëpërfshirëse të pordorimit të veglave Inxhinierike të STEP 7, si dhe teknologjisë softverike të orientuar në bazë të jetëgjatësisë së softverit.

Gjithashtu ofrojnë përmirësime dhe qark punues më fleksibil, duke filluar që nga 32 lidhje aktive me nyjet e tjera, p.sh., veglat e programimit dhe panelet operatore, ku gjithashtu mund të ndërtohen njëkohësisht.

Më shumë se në tri versione të larta CPU-t janë në dispozicion për aplikacione të ndryshme:

- 317-2 DP standardi CPU, është i përshtatshëm për detyrat më të shpeshta të kontrollimit me shpërndarje të lartë të funksioneve komunikative. Njësoj DP ndërfaqet janë në dispozicion si kombinim i ndërfaqeve DP/MPI, dhe mund të konfigurohen me cilindo nga PROFIBUS-ët të larta, ose PROFIBUS-ët e ulëta,

- Fail-Safe (dështim-siguri) 317F-2 DP CPU ofron sistemin e sigurisë së dështimit në zgjerim në kompromis me standardet CPU, dhe PROFIsafe për komunikim të sigurt. Kompletohet me specifikimin e standardeve të fuqishme apo të mëdha:
  - IEC 61508 (SIL 3),
  - EN 954 (kategoria 4) dhe
  - NFPA 79, NFPA 85.

Ka aprovimin nga Inspeksioni Teknologjik Gjerman (TUV). Programet e përshtatshme dhe të sigurta mund të programohen duke përdorur STEP 7 LAD dhe FBD, ku këto janë gjuhët dhe certifikimi i shembujve të programimit nga libreria F e Shpërndarjes së sigurtë. Për zgjerim të mëtutjeshëm janë në dispozicion fail-safe ET 200S dhe ET 200M [4].

- Teknologjia CPU 317T-2 DP ngërthen në vete teknologji të fuqishme, dhe funksionet e kontrollimit të lëvizjeve në CPU. Është dizajnuar për kontrollimin e lëvizjeve dinamike dhe akseve të shumëllojshme. Para-programimi i PLC-së bën hapjen e butë, funksionin i kontrollit të lëvizjeve, integrimin diskret I/O dhe barazlargimin e lëvizjeve të PROFIBUS DP. Mundëson kontrollin fleksibil të lëvizjeve dhe akseve të veçanta, p.sh., kontrollimi i pozicionimit, sinkronizimi dhe/ose ndryshimi përmes kompjuterit. STEP 7 mundëson konfigurimin dhe parametrizimin e akseseve.



*Fig.4.4. CPU 317-2 DP\_ CPU standarde me dy DP Interfaces (ndërfaqie)*



*Fig.4.5. CPU 317T-2 DP\_teknologjia CPU për funksionin e kontrollit të lëvizjeve*

#### **4.1.7. Gjashtë kompaktësitë e CPU-së**

- CPU 312C
- CPU 313C
- CPU 313C-2 PtP
- CPU 313C-2 DP
- CPU 314C-2 PtP
- CPU 314C-2 DP

Me integrimin e I/O dhe funksionet teknologjike, programi vazhdimisht është i ripërtirë dhe ka treguar funksionalitet dhe performancë të lartë si:

- Përvetësimi i shpejtësisë së vlerave aktuale për numërimin dhe matjen periodike, mundëson përmirësimin e shkëlqyeshëm dinamik. P.sh për pozicionimin e problemeve. Procesimi i trefishtë i shpejtësisë për pikën qarkulluese operon me shumë shpejtësi ekzekutimin e programit.
- Mbrojtja e kopjes së përdorimit të softverit mund të implementohet duke e skenuar numrin serial të MMC gjatë operimit.
- Një numër i rritur i funksioneve të thirrjes dhe blloqeve të të dhënave, lehtëson bartjen e programeve të përdorura të cilat janë krijuar për CPU “standard”, dhe tani përdoren si CPU kompakte.

## **4.2 Shembulli 1: Numërimi dhe Krahasimi i Urdhërave**

### **4.2.1. Zona e Ruajtjes me numërues dhe krahasues**

Figura në vazhdim paraqet një sistem me dy shirita transportues dhe një zonë të magazinimit apo ruajtjes së përkohëshme në mes tyre. Shiriti transportues “1” dërgon pakot në zonën e magazinimit. Një pengesë fotoelektrike (SENSOR) në fund të shiritit transportues 1 në afërsi të zonës së magazinimit, bën përcaktimin se sa pako janë dorëzuar (zbrazur) në zonën e magazinimit. Shiriti transportues 2, transporton pakot nga zona e magazinimit në një vend ng i tregues që përfshin 5 ndriçues, përcjellë mbushjen e pakove të caktuara në zonën e depos së përkohëshme. [6], [7].







Figura 4.6. Paneli tregues në shiritin transportues.

**4.2.2. Programimi logjik që i aktivizon llambat e indikatorit në panelin tregues**


Qarku 1: Numëruesi (Counter) C1 numëron çdo ndryshim sinjali nga “0” në “1” në hyrjen CU, dhe numëron secilin ndryshim-zbritje të sinjalit nga “0” në “1” në hyrje të CD. Me një ndryshim të gjendjes nga “0” në “1” në hyrje të S, vlera e numëruesit është vendosur në vlerën PV. Një ndryshim sinjali në gjendjen nga “0” në “1” në hyrjen R, rivendosë vlera në numërues në gjendjen “0”. MW200 përmban vlerën aktuale për numëruesin C1. Q12.1 tregon “zonë magazinimi jo bosh”.




Qarku 2: Q12.0 tregon “zonën e magazinimit të hapur”.




Qarku 3: Nëse vlera e numëruar është më e vogël ose e barabartë me 50 (me fjal të tjera nëse vlera e numëruar aktuale është më e madhe ose e barabart me 50), llamba e indikatorit për “zonën e depos 50% të mbushur” është ndezur.



Qarku 4: Nëse vlera e numruar është më e madhe ose e barabart me 90, llamba e indikatorit për “zonën e mbushur 90%” është ndezur.



Qarku 5: Nëse vlera në numruar është më e madhe ose e barabart me 100, llamba e indikatorit për “zonën e magazinimit të mbushur (plotësuar)” është ndezur.



### 4.3 Shembulli 2: Udhëzimet matematikore

#### 4.3.1. Zgjedhja e problemeve matematikore

Një program i thjeshtë na tregon se si mund të përdorim udhëzimet matematikore për të përfituar rezultatin e ekuacionit në vazhdim:


$$MW4 = ((IW0 + DBW3) \times 15) / MW0$$

#### 4.3.2. Programi logjik "Ladder"

Çarku 1: Hapja e bllokut të të dhënave DB1



Çarku 2: Fjala hyrëse IW0 është përcaktuar për të shpërndarë fjalën e përbashkët të të dhënave DBW3 (blloku i të dhënave duhet të përcaktohet dhe të hapet), dhe shuma është ngarkuar në fjalën e memorien MW 100. MW 100 pastaj është shumëzuar me 15, dhe përgjigjëjet ruhen në fjalën MW102 të kujtesës. MW 102 është e ndarë nga MW0 me rezultatin e ruajtur në MW4.



### 4.4. Shembulli 3: Udhëzimi i fjalës logjike

#### 4.4.1. Sistemi i ngrohjes së furrës

Operatori për ngrohjen e furrës fillon duke e shtyrë butonin e shtytjes Start. Ky operator mund ta ketë përcaktuar gjatësinë e kohës për ngrohje, duke përdorur butonin në formë timoni të treguar në figurë. Vlerën që përcakton operatori tregon sekondat e përcaktuar në binarë (BCD) në formë decimale [3], [5].




Figura 4.7. Tregon metoden manuale për startim, duke shtypur butonin me dorë.

Komponentet e sistemit	Adresa absolute
Shtyp butonin start	I 0.7
Treguesi për njëshe	I 1.0 to I 1.3
Treguesi më i lartë	I 1.4 to I 1.7
Treguesi për qindra	I 0.0 to I 0.3
Fillimi i ngrohjes	Q 4.0

Tabela 4.2. Treguesi i komponenteve të sistemit dhe adresat absolute.

**4.4.2. Program logjik shkallë “Ladder Logic”**


Qarku 1: Nëse kohuesi është në funksion, atëher vëhet në funksion ngrohësi.



Qarku 2: Në qoftë se kohuesi është duke punuar, udhëzimi rikthehu përfundon procedimin këtu.



Qarku 3: Biti i maskës hyrëse I0.4 përmes I0.7 (rikthen atë në gjendjen 0). Këto bite të treguesit hyrës në mënyrë rotative duke startur me anë të gishtit tregues, nuk janë përdorur. Të 16 pjesët (bitët) të hyrjeve janë kombinuar me W#16#0FFF në bazë të udhëzimit (Word) dhe përshkrimit të wordit. Rezultati është ruajtur në memorien me fjalë MW1. Me qëllim për të caktuar kohën bazë në sekonda, vlera prezente është kombinuar me W#16#2000 në bazë të fjalës (Word), ose udhëzuesit të fjalëve, rregullimin e bitëve nga 13 në 1, dhe rivendosjen e bitëve 13 drejt 0.



Qarku 4: Starto kohuesin T1 si pulsant kohor i zgjëruar, nëse butoni start është shtypur dhe ruhet si vlerë prezente në memorien me fjalë MW2 (rrjedhë nga logjika më lart).



# KAPITULLI V

## 5. Zgjidhja e elementeve përbërëse të robotit

### 5.1 Elementet përbërëse të shiritit transportues dhe robotit skara

#### 5.1.1 Aplikime praktike

Secili udhëzues logjik përshkruhet në këtë manual me një operacion specifik. Nëse kombinojmë këto udhëzime në program, mund të realizojmë një shumëllojshmëri detyrash të automatizimit. Në këtë kapitull shqyrtohen shembuj të aplikimit praktik të shënuar më poshtë:

Kontrollimi i shiritit transportues duke përdorur udhëzuesin e bitit logjik.

Detektimi e drejtimit të lëvizjeve në shiritin transportues duke përdorur udhëzuesin e bitit logjik.

Gjenerimi i pulseve të orës duke përdorur udhëzimet kohore [3], [7].

Mbajtja e rrugës, drejtimit nga depoja duke përdorur udhëzimet e numërusit dhe krahasuesit.

Zgjedhja e një problemi duke përdorur udhëzimet matematikore.

Caktimi i gjatësisë së kohës për nxehjen e një furrë.

#### 5.1.2 Udhëzimet e përdorura

Tab. 5.1. Udhëzimet e përdorura

Memorja	Elementet e programit	Pershkrimi i katalogut
WAND_W	Udhëzimi i fjalëve logjike	(fjalë) dhe fjalë
WOR_W	Udhëzimi i fjalëve logjike	(fjalë) ose fjalë
---(CD)	Numërues	Unaza numëruse e poshtme
---(CU)	Numërues	Unaza numëruse e epërme
---(R)	Udhëzimet e bitit logjik	Rivendosje e unazës
---(S)	Udhëzimet e bitit logjik	Vendosje e unazës
---(P)	Udhëzimet e bitit logjik	RLO kufiri pozitiv
ADD_I	Udhëzimet e pikes qarkulluse	Vendos kufirin (integrimin)
DIV_I	Udhëzimet e pikes qarkulluse	Ndaje kufirin (integrimin)
MUL_I	Udhëzimet e pikes qarkulluse	Kufiri i shumëllojshëm
CMP <=	Krahason	Krahason kufijt (integrimin)
—   —	Udhëzimet e bitit logjik	Kontaktet e hapura normale
—  /  —	Udhëzimet e bitit logjik	Kontaktet e mbyllura normale
—()	Udhëzimet e bitit logjik	Unaza e prodhimit
---( JMPN )	Kalimi	Kalo-nëse-jo
---( RET )	Kontrollimi i programit	Rikthim
MOVE	Lëviz	Cakto vlerën e lëvizjes
--- ( SE )	Kohor	Unaza e zhgjeruar kohore

## 5.2. Elementet përbërëse të shiritit transportues dhe robotit skara

### 5.2.1 Shiritit transportues me elementet përbërëse




Fig. 5.1. Shiriti transportues.

### 5.2.2 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit të tretë





Fig. 5.2. Roboti Skara aksi i tretë.



### 5.2.3 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit dytë



*Fig. 5.3. Roboti Skara aksi i dytë.*

### 5.2.4 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit të parë dhe me komandat e lëvizjes





Fig. 5.4. Roboti Skara aksi i parë.


Shiriti transportues i cili gjindet në laboratorin e FIM-së me pajisjet përcjellëse: motori, sensorët, shiriti, kutia komanduese në mënyrë manuale, si dhe pjesa e cila transportohet dhe komandohet përmes programimit logjik SIMATIC S7-300.



*Fig. 5.5. Shiriti transportues.*

Cilindri pneumatik i lidhur me sensorë, i cili shërbenë për largimin e pjesës nga shiriti transportues në mënyrë të programuar, ku me ardhjen e pjesës tek sensor i detektues, motori ndalet, largohet pjesa me ndihmën e cilindrit pneumatik, në shirit tjetër transportues apo në

ndonjë pako, dhe cilindri kthehet në pozitën normale pra në pikën zero, dhe në mënyrë automatike përsëri fillon punën motori. Ky cikël përsëritet çdo herë.




*Fig. 5.6. Cilindri pneumatik.*

## KAPITULLI VI

### ***6. Programimi i blloqeve funksionale, me përshkrimin e sistemit dhe programimin e shiritit transportues përmes Simatic S7-300***

#### ***6.1. Programimi i shiritit transportues***

Para se të fillojmë programimin e një PLC duhet ta kemi të qartë se ekzistojnë disa rregulla programore paraprake, ku në qoftë se nuk i zbatojmë ato rregulla pothuajse është e pamundur që të programohet një PLC [4], [5], [6], [7].



*Fig. 6.1. Realizimi i punës së shiritit transportues.*



Duke u nisur nga rregullat fillestare për programim, si dhe zbatimi i tyre në përpikmëri, janë krijuar disa blloqe programuese, blloqe të cilat në vete kanë nënblloqe të programuara dhe të integruara njëra me tjetrën, në mënyrë që shiriti transportues të programohet sipas nevojë.

Cikli i programimit është i përbërë nga:

OB1 – Programi kryesor, me nënprograme; FB1, FB2, FC1, DB1, DB2, si dhe blloqe funksionale: FB60, FB62, FB80, FB81, FC60, FC61, FC62, FC63, SFB52.




Tabela 6.1. Organizimi i blloqeve, cikli i programimit për shiritin transportues.

Interface	Name	Data Type	Address	Comment
TEMP	OB1_EV_CLASS	Byte	0.0	Bits 0-3 = 1 (Coming event), Bits 4-7 = 1 (Event class 1)
	OB1_SCAN_1	Byte	1.0	1 (Cold restart scan 1 of OB 1), 3 (Scan 2-n of OB 1)
	OB1_PRIORITY	Byte	2.0	Priority of OB Execution
	OB1_OE_NUMBER	Byte	3.0	1 (Organization block 1, OB1)
	OB1_RESERVED_1	Byte	4.0	Reserved for system
	OB1_RESERVED_2	Byte	5.0	Reserved for system
	OB1_PREV_CYCLE	Int	6.0	Cycle time of previous OB1 scan (milliseconds)
	OB1_MIN_CYCLE	Int	8.0	Minimum cycle time of OB1 (milliseconds)
	OB1_MAX_CYCLE	Int	10.0	Maximum cycle time of OB1 (milliseconds)
	OB1_DATE_TIME	Date_And_Time	12.0	Date and time OB1 started
	A	Word	20.0	
	B	Word	22.0	

Tabela 6.2. Struktura e blloqeve në programin burimorë.

## 6.2. SHPJEGIMI I BLOQEVË FUNKSIONALE TË PROGRAMIMIT TË SHIRITIT TRANSPORTUES

### 6.2.1. OB1 – Cikli i programimit dhe Organizimi i Blloqeve

Sistemi operativ i CPU S7 ekzekuton organizimin e bllokut OB1 periodikisht. Kur blloku i organizuar OB1 është ekzekutuar, sistemi operativ fillon përsëri realizimin. Ekzekutimi ciklik OB1 është nisur pas fillimi, dhe cikli përfundon komplet. Në gjithashtu mund të krijohet blloqe të tjera funksionale (FBS, SFBs) ose funksionet (FCS, SFCs) në organizimin e blloqeve OB1.

### 6.2.2. Kuptimi i funksionimit të bllokut OB1

OB1 ka prioritet më të vogël ndaj të gjithë OBs-ve në zhvillim nga një cikël i monitoruar, me fjalë të tjera, të gjitha OBs tjera përveç OB90 mund ta ndërpresin ekzekutimin e OB1. Zhvillimet e mëposhtme të shkaktuara nga sistemi operativ për të thirrur OB1:

- Fillimi i përfunduar,
- Ekzekutimi OB1 (cikli i mëparshëm) ka përfunduar.

Kurë OB1 është ekzekutuar, sistemi operativ i dërgon të dhënat e përgjithshme. Para se të ristartohet OB1, sistemi operativ shkruan tabelën përfundimtare të procesit të pasqyrimin dhe të moduleve prodhuese-dalëse për realizime të ndryshme programuese, dhe kjo përditson tabelën e hyrjeve, dhe procesit të pasqyrimin që gjithashtu merr të dhëna të përgjithshme për një CPU.

S7 monitoron kohën maksimale, duke siguruar një kohë maksimale për përgjigjëje. Vlera maksimale për kohën e pasqyruar paraprakisht është 150 ms. Ne mund të vendosim një vlerë të re, ose mund të rrisim monitorimin e kohës kudo në programin tonë me SFC43"RE\_TRIGR". Nëse programi kalon kohën maksimale të ciklit OB1, sistemi operativ e thërret bllokun OB80 (OB kohë e gabuar); nëse OB80 nuk është programuar, CPU ndryshon me mënyrën STOP.

Përveç monitorimit maksimal të kohës, gjithashtu është e mundur për tu garantuar edhe një kohë minimale. Sistemi operativ do të shtyj fillimin e një cikli të ri (shkrim i tabelës prodhuese në procesin e imazhit të moduleve të prodhimit), derisa të arrihet koha minimale.

### 6.2.3. Të dhënat lokale për OB1

Në Tabelën 6.3. janë paraqitur variablat, tipet si dhe përshkrimi për OB1.

Variabli	Tipi	Përshkrimi
OB1_EV_CLASS	BYTE	Klasë-veprimtaria dhe identifikuesit: B#16#11: OB1 aktiv
OB1_SCAN_1	BYTE	<ul style="list-style-type: none"> <li>• B#16#01 përfundim i një ristarti të ngrohtë</li> <li>• B#16#02 përf. i një ris. Të nxehtë</li> <li>• B#16#03 përf. i ciklit kryesorë</li> <li>• B#16#04përf. i një</li> </ul>

		cikli të ftohët B#16#05 cikli i parë OB1 në një CPU pas kalimit në gjendjen STOP
OB1_PRIORITY	BYTE	Klasë prioriteti 1
OB1_OB_NUMBR	BYTE	Numri OB1 (01)
OB1_RESERVED_1	BYTE	E rezervuar
OB1_RESERVED_2	BYTE	E rezervuar
OB1_PREV_CYCLE	INT	Koha e mëparshme e skanimit ( ms )
OB1_MIN_CYCLE	INT	Koha minimale e ciklit (ms) që nga fillimi i fundit
